



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.20/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ i organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore _____ dyshuar për shkelje disiplinore, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat. zni. Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, pala ankuese _____ e përfaqësuar nga _____ avokat, dhe përmbaruesi privat, _____ pas mbyjjes së seancës së këshillimit dhe votimit, me datën 30.12.2020, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

- I. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat, _____ i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore _____ është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2 të LPP-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbaruesi privat, _____ shqiptohet masa disiplinore "vërejtje" e paraparë me nenin 368 par 1, pika 1.1 të LPP-së.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2020, pala ankuese, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë, e cila është plotësuar me datën 06.11.2020 me të cilat ka kërkuar fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat _____ i organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e për Territorin e Gjykatës Themelore _____ .Pala ankuese pretendon se i njëjti ka kryer një vargë shkeljes disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 2123/20. Pala ankuese pretendon që përmbaruesi ka lëshuar urdhër për përmbarim me datën 07.10.2020 dhe se ata kanë paguar në mënyrë vullnetare, përveç obligimeve ndaj kreditorit edhe

shpenzimet e procedurës përbarimore siç janë kërkuar brenda afatit ligjor. Sipas palës ankuese ata nuk duhej të ngarkoheshin me shpenzime tjera. Ngarkesa me shpenzime tjera, sipas palës ankuese, nuk ka bazë juridike.

Përmbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi që pala ankuese është e vërtetë se ka paguar borxhin kryesor dhe taksën për administrimin e lëndës por nuk ka përmbushur pagesën e kamatës ligjore dhe shpenzimet tjera të procedurës siç është theksuar në urdhër. Përmbaruesi privat thekson se ngarkesa me shpenzimet e procedurës pas dështimit të përmbushjes së plotë të pagesës sipas urdhërit përbarimor, është bërë në pajtim me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ për Tarifën e Përmbaruesit Privat përkatësisht nenin 27 të LPP-së me të cilën specifikohet në mënyrë të qartë se kur caktohet afati vullnetar për përmbushje të detyrimit nga debitori. Sipas përmbaruesit "*afati i tillë caktohet vetëm nëse në dokumentin përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit.*" Përmbaruesi privat thekson që pala ankuese është njoftuar se nuk ishte përmbushur në tërësi urdhri përbarimor dhe se në rast të mospagesës do të vazhdohet me procedurë.

Me datën 30.12.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Notarinë dhe Përbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore; pala ankuese dhe përmbaruesi privat,

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Notarinë dhe Përbarimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës penale ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se mbetet pranë pretendimeve të theksuara me shkrim se përmbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, nën par 1.1, 1.2, 1.4, dhe 1.7, të LPP sepse i njëjti me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përbarimore në lëndën P. nr 2123/20, ka shkelur ligjin dhe ka tejkaluar autorizimet ligjore.

Përfaqësuesi e palës ankuese ka bërë shtjellimin e ankesës duke theksuar se qëndron pranë pretendimeve të paraqitura me shkrim. Gjithashtu edhe përmbaruesi privat gjatë seancës ka paraqitur qëndrimin e tij se pretendimet e palës ankuese nuk janë të bazuar prandaj ka kërkuar nga Komisioni ta refuzoj atë.

Komisioni gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar: propozimin për përbarim të dt 02.12.2020; Urdhërin për përbarim dt 02.10.2020; Detajet e Transaksionit në NLB dt 07.10.2020; Komunikimet-Korrespondencat përmes Postës Elektronike; Pasqyra e Shpenzimeve; Eksperiza Financiare dt 08.10.2020 dhe Faturat: dt 31.10.2019, 30.09.2019 dhe 31.08.2019.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se i përmbaruesi privat ka kryer veprë disiplinore.

Komisioni vëren që Urdhëri Përbarimor në mënyrë të qartë përcakton se pala ankuese obligohej ta përmbushte detyrimin brenda afatit "*7 ditore nga data e dorëzimit të urdhërit, shumën prej*

1,676.63 €, me kamatëvonesë prej 8 % në vit duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi." Nuk është kontestuese që pala ankuese në këtë rast kishte përmbushur vullnetarisht borxhin kryesor dhe gjithashtu edhe tarifën për administrimin e lëndës brenda afatit të përcaktuar në urdhërin përmbartimor. Këtë nuk e konteston as pala ankuese dhe as përmbartuesi privat. Nuk është kontestuese as fakti se pala ankuese nuk kishte bërë pagesën e kamatës ligjore. As pala ankuese nuk pretendon se kishte bërë pagesën e kamatës.

Komisioni vëren se meqenëse pala ankuese përkatësisht debitorit nuk kishte përmbushur urdhërin në tërësi, përkatësisht nuk kishte bërë pagesën e kamatës në shumën prej 8 % duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, është ngarkuar me shpenzimet tjera të procedurës përmbartimore. Kjo ngarkesë, në vlerësimin e Komisionit, nuk ishte në përputhje, me dispozitat juridike. Pala ankuese kishte përmbushur borxhin kryesor dhe po ashtu edhe shpenzimet për administrimin e lëndës. Ajo që nuk ishte përmbushur nga pala ankuese është vetëm kamata prej 8 %, siç përcaktohet në urdhërin për përmbartim. Udhëzimi Administrativ AD-NR.01/2017, në tabelën 1, përcakton tarifën për efikasitetin e zbatimit të përmbartimit. Efikasiteti përcaktohet nga vlera e papërmbushur. Meqenëse pala ankuese kishte përmbushur borxhin kryesor, atëherë tarifa e efikasitetit mund të përcaktohet vetëm në vlerën e kamatës së papërmbushur e jo në edhe në borxhin kryesor. Në rastin në ljalë, përmbartuesi privat kishte ngarkuar palën ankuese me tarifën e efikasitetit sikurse pala ankuese të mos kishte përmbushur fare borxhin kryesor. Rrjedhimisht, Komisioni vjen në përfundim se përmbartuesi nuk ka vepruar në përputhje me ligjin.

Për sa i përket llojit dhe lartësisë së masës, Komisioni vlerësoi të gjitha rrethanat e rastit, përgjigjen e përmbartuesit dhe pas analizës së tyre, gjen se masa e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbartuesit. Komisioni vlerëson se masa e shqiptuar është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmbartuesin si dhe tek përmbartuesit tjerë që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbartjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbartimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr 20/2020, datë 30.12.2020

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISHRI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.